

RAPORT I TRAJNIMIT

Titulli: Korniza Kurrikulare e Kosovës (KKK) në programin parafillor

Data: 8 korrik 2023

Vendi: Salla A-208, Kolegji AAB

Trajnere: Diana Qarkaxhija

Qëllimi i trajnimit:

Qëllimi i trajnimit ishte të pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe kompetenca profesionale mbi Kornizën Kurrikulare të Kosovës, me fokus të veçantë në programin parafillor, si dhe t'i aftësojë ata në përgatitjen e planifikimeve arsimore të përputhura me këtë dokument strategjik.

Përmbajtja e trajnimit:

- Analizë e strukturës së KKK-së dhe rolit të saj në edukimin e hershëm
- Prezantimi i kompetencave kyçe dhe lidhja e tyre me fushat e të nxënit
- Rëndësia e qasjes së bazuar në kompetenca në arsimin parafillor
- Udhëzime për hartimin e planeve mësimore sipas KKK-së
- Shembuj praktikë të planifikimit vjetor, mujor dhe ditor
- Diskutim mbi sfidat dhe mundësitë e zbatimit të KKK në kontekstin kosovar

Rezultatet e trajnimit:

- Pjesëmarrësit përvetësuan njohuri thelbësore mbi Kornizën Kurrikulare të Kosovës
- U rrit vetëdija për rëndësinë e planifikimit të bazuar në kompetenca
- Studentët u angazhuan në ushtrime praktike që i përgatitin për zbatim në fushën profesionale
- Trajnimi ndihmoi në ndërlidhjen midis teorisë kurrikulare dhe praktikës mësimore